



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 698/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkritazi për apelin e Ibrahim Makollit në cilësinë e kandidatit për deputet ne Kuvend e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimeve të PZAP-it, Anr. 380/2010, Anr. 381/2010, Anr. 382/2010 të datës 11.12.2010 dhe Anr. 388/2010 dt. 12.12.2010, në seancën e panelit të mbajtur me 06.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet poshtë apeli si i pasafatshëm i subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një apel më datë 29.12.2010, nga Ibrahim Makolli në cilësinë e kandidatit për deputet ne Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, me te cilën pretendohet se vendimet: Anr. 380/2010, Anr. 381/2010, Anr. 382/2010 të datës 11.12.2010 dhe Anr. 388/2010 dt. 12.12.2010, po qe se shikohen fotot me vëmendje ato janë të njëjtës ditë dhe të njëjtit vend që do të thotë sipas parashtruesit të apelit se bëhet fjalë për rastin e njëjtë. Parashtruesi i apelit thekson se vetë ai ka qenë hartues i Rregullës për Zgjedhje dhe duke e njohur mirë atë, ka bërë përpjekje maksimale që të mos ketë shkelje të asaj natyre nga ana e tij.

Neni 8 paragrafi 5 i Rregullave dhe Procedurave te PZAP - it, parasheh:

Në lidhje me apelimin e një vendimi të KQZ-së, apeli duhet të dorëzohet brenda 24 orëve pas njoftimit të KQZ-së. Për te gjitha apelet tjera, përveç nëse është saktësuar diku ndonjë afat tjetër, apelet duhet të dorëzohet brenda shtatëdhjetë (72) e dy orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-it nga parashtruesi.

PZAP-i gjeti se;

- apeli është i pasafatshëm.

Sipas shkresave të lëndës rrjedh se PZAP-i vendimet i ka marr : Anr. 380/2010, Anr. 381/2010, Anr. 382/2010 të datës 11.12.2010 dhe Anr. 388/2010 dt. 12.12.2010, ndërsa apeli ndaj këtyre vendimeve është pranuar në PZAP më datë 29.12.2010. Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur në të cilën theksohet se nga pranimi i vendimit të PZAP-it parashtruesi ka afat shtatëdhjetë e dy (72) orë për apelimin e vendimit të PZAP-it që në rastin konkret parashtruesi i apelit nuk e ka shfrytëzuar afatin e përcaktuar. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 698/2010 më datën 06.01.2011

